



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 65, datë 25.06.2024



PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, TË PASURIVE ME NR. 55/12, 55/96; 55/15 DHE 55/17, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 150.5 M², ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3690, VADARDHË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 13, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 669, datë 07.8.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH) si metadatë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale”, si dhe në vijim të shkresës me nr. 4368/3 prot., datë 05.6.2024, dalë nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me lëndë: “Përcjellje të projekt zbatimit të objektit “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Vadardhë Sukth”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Sukth, të pasurisë me nr. 55/12, e llojit Shesh, me sipërfaqe 478.9 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3690, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Vadardhë.
2. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Sukth, të pasurisë me nr. 55/96, e llojit Ledh, me sipërfaqe 60.6 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3690, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Vadardhë.
3. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Sukth, të pasurisë me nr. 55/15, e llojit Truall, me sipërfaqe 118.6 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3690, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Vadardhë.
4. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Sukth, të pasurisë me nr. 55/17, e llojit Shesh, me sipërfaqe 842.4 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3690, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Vadardhë.
5. Pasuritë e përcaktuar në pikën 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet Vendimit nr. 297, datë 28.4.2010, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut të Durrësit".
6. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.06.2024



Lidhja 1
Bashkia Durrës, Njësia Administrative Sukth

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
-	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
-	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
-	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
-	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi





Legjenda

Parcelat

Shtresë Bază

Renditë Bashkia


Renditë Kufiri Tokësor

Renditë Kufiri Tokësori





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 389 / prot.

Durrës, më 01.07 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.65 datë 25.06.2024 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Sukth, të pasurive me nr. 55/12, 55/96; 55/15 dhe 55/17, e llojit truall, me sipërfaqe të përgjithshme 150.5 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3690, Vadardhë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

